



Tekst zyrtar siç është amendamentuar me 11.11.2010

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

Në bazë të nenit 11.5 dhe 64.2 (a) dhe (b) të Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës dhe nenit 29.1 dhe 20 të Ligjit nr. 03/072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, nxjerr:

RREGULLËN ZGJEDHORE Nr. 05/2008
KUTITË POSTARE TË SUBJEKTEVE POLITIKE

Neni 1

Dispozitat e përgjithshme

1.1 Zyra për Regjistrim të Partive Politike dhe Certifikim (më tutje “Zyra”) do të krijojë dhe mirëmban kutitë postare për secilin subjekt politik të certifikuar nga KQZ-ja, siç përcaktohet në nenin 3 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës . Kutitë postare do të vendosen në ndërtesën e Sekretariatit të KQZ-së në Prishtinë.

1.2 I gjithë letërkëmbimi i shkruar zyrtar me Subjektet Politike duhet të bëhet me personin për kontakte të Subjektit Politike në kutitë postare me përjashtim të nenit 4.2, 5.3 dhe 5.4 të kësaj Rregulle.

1.3 Zyra krijojë kuti postare të veçanta për korrespondencë nga subjektet politike për KQZ-në, Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP) dhe Zyrën. KQZ-ja dhe PZAP-i mund të mbajnë korrespondencë me subjektet politike të certifikuara edhe në mënyra të tjera përveç me kutitë e tyre postare.

1.4 Kutitë postare për KQZ-në, PZAP-in dhe Zyrën u vihen emërtime të qarta në bazë të Ligjit mbi përdorimin e gjuhëve zyrtare në Kosovë.

1.5 KQZ-ja, PZAP-i dhe Zyra mund t’i dorëzojnë subjektit politik çfarëdo dokumenti duke shfrytëzuar kutinë postare të subjektit politik. KQZ-ja, PZAP-i dhe Zyra do të shënojnë kohën në të cilën ata do të vendosin çfarëdo shkresë në kutinë postare të subjektit politik.

1.6 Zyra duhet ta njoftojë secilin subjekt politik se është krijuar kutia e tij postare dhe secilit subjekt do t’ia sigurojë nga një kopje të çelësit dhe të kësaj Rregulle të zgjedhjeve. Subjekti politik që e humbet çelësin e kutisë postare për ta zëvendësuar atë duhet ta paguajë tarifën prej 5 (pesë) Eurove Zyrës.

1.7 Zyra përmes librit të protokollit evidenton çdo shkresë apo dokument të vendosur në kutitë postare për subjektet politike dhe anasjelltas

Neni 2
Obligimet e subjektit politik

2.1 Secili subjekt politik i certifikuar, për të marrë pjesë në zgjedhje, duhet ta kontrollojë kutinë e vet postare së paku dy here në javë (çdo të marte dhe të premte) prej kohës kur personi kontaktues i subjektit politik e merr çelësin e deri në fillim të periudhës së fushatës.

2.2 Prej fillimit të periudhës së fushatës e deri në certifikimin e rezultateve të zgjedhjeve, subjektet politike të certifikuara duhet t'i kontrollojnë kutitë e veta postare, çdo ditë përveç të dielës.

Neni 3
Dorëzimi i dokumentit në kuti

3.1 Shkresa ose dokumenti që dërgohet në kutinë postare të subjektit politik para periudhës së fushatës do të konsiderohet se është dorëzuar te ai subjekt në orën 16:00, të martën ose të premten pas datës në të cilën letërkëmbimi është vendosur në kutinë postare të atij subjekti.

3.2 Shkresa ose dokumenti që dërgohet në kutinë postare të subjektit politik gjatë periudhës së fushatës do të konsiderohet se i është dorëzuar atij subjekti:

(a) në orën 16:00 në ditën në të cilën korrespondenca është vendosur në kutinë postare të subjektit, nëse ajo është vendosur në kutinë postare të subjektit para orës 10:00 ose

(b) në orën 16:00 një ditë pas vendosjes së korrespondencës në kutinë postare të subjektit, nëse ajo është vendosur në kutinë postare të subjektit pas orës 10:00.

3.3 Gjatë kohës para periudhës së fushatës, Zyra do ta njoftojë paraprakisht personin kontaktues të subjektit politik se korrespondenca (materiali) do të vendoset në kutinë e tij postare. Subjekti politik, të cilit i është dhënë njoftim paraprak për dërgimin e korrespondencës, (materialit, dokumentit), do të konsiderohet se e ka marrë korrespondencën në ditën e vendosjes së dokumentit në kutinë postare.

Neni 4
Korrespondenca nga subjektet politike

4.1 Me përjashtim të nenit 4.2, subjektet politike mund të dërgojnë korrespondenca zyrtare në KQZ, PZAP-i dhe Zyrë përmes kutive të veta postare.

4.2 Subjekti politik duhet t'ia dërgojë Zyrës personalisht dhe vetëm me caktim të terminit këto dokumente:

- (a) listat e kandidatëve;
- (b) kërkesat për akreditim të vëzhguesve dhe
- (c) formularët e publikimit financiar të fushatës.

4.3 KQZ-ja, Zyra dhe PZAP-i i kontrollojnë kutitë e tyre postare dy herë në ditë dhe do të shënojnë datën dhe kohën në të cilën ata marrin çdo korrespondencë nga subjekti politik.

Neni 5

Subjektet politike që kanë selitë jashtë Prishtinës

5.1 Zyra e autorizon Zyrtarin Ekzekutiv Komunal të Zgjedhjeve (më tutje “ZE i KZ-së”) si person kontaktues për zgjedhje për secilin subjekt politik të certifikuar që e ka selinë e vet jashtë Prishtinës.

5.2 Personi kontaktues për zgjedhje (ZE i KZ-së) do të sigurojë korrespondencën nga KQZ-ja, PZAP-i dhe Zyra për subjektin politik dhe nga subjekti politik për KQZ-në ,PZAP-in dhe Zyrën sa më parë që të jetë e mundur.

5.3 Me përjashtim të neneve 4.2 dhe 5.4 të kësaj Rregulle, subjekti politik mund të dërgojë korrespondencën në KQZ, PZAP dhe Zyrë përmes personit të tij për kontakt lidhur me zgjedhjet.

5.4 Subjektet Politike duhet ti dërgojnë Raportet e tyre Financiare dhe çdo korrespondencë që lidhet me raportet financiare personalisht në Zyrë.

5.5 Personi kontaktues për zgjedhje (ZE i KZ-së) duhet të shënojë kohën në të cilën çdo korrespondencë i është dërguar subjektit politik ose është marrë prej tij.

5.6 Secili subjekt politik i certifikuar duhet të dërgojë përfaqësuesin për të marrë korrespondencën nga personi për kontakte të cilin e cakton Zyra (ZE i KZ-së), lidhur me zgjedhjet, ose së paku çdo të marte dhe të premtë deri në fillim të periudhës së fushatës.

5.7 Secili subjekt politik i certifikuar duhet të dërgojë përfaqësuesin për të marrë korrespondencën nga personi për kontakte (ZE i KZ-së) lidhur me zgjedhjet, çdo ditë përveç të dielës, që nga fillimi i periudhës së fushatës deri në certifikimin e rezultateve të zgjedhjeve.

5.8 Gjatë kohës para periudhës së fushatës, personi kontaktues për zgjedhje (ZE i KZ-së) e njofton personin kontaktues të subjektit politik se e ka marrë korrespondencën. Subjekti politik, të cilit i është dhënë njoftimi paraprak për dërgimin e korrespondencës, do të konsiderohet se e ka marrë korrespondencën një ditë pas atij njoftimi.

Neni 6 Hyrja në fuqi

Kjo Rregull e ndryshuar zëvendëson Rregullën e mëparshme mbi Kutitë Postare të Subjekteve Politike dhe hyn në fuqi më 08.11.2010.

Nesrin Lushta

Kryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve